

LEONARD TOPUZI – ADZM DIBËR

Drejtor i Administratës së Zonave të Mbrojtura Dibër (ADZM Dibër).

Z. Leonard Topuzi ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Dibër.

Me formim në fushën e financës dhe bankës, z. Topuzi është diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, ku ka përfunduar studimet Bachelor në degën Financë-Bankë gjatë periudhës 2011–2014 dhe më pas Masterin Shkencor në të njëjtën fushë gjatë viteve 2014–2016.

Gjatë karrierës së tij profesionale, z. Topuzi ka mbajtur disa pozicione pranë Bashkisë Dibër, ndër të cilat Administrator i Njesisë Administrative Zall Dardhë, Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve Publike, si dhe Drejtor i Mbrojtjes Civile. Këto përvoja i kanë mundësuar të ndërtojë një profil të konsoliduar në administratën publike, financë, prokurime, inspektim dhe menaxhim institucional.

Gjatë karrierës së tij profesionale, z. Topuzi ka ndjekur trajnime të ndryshme, përfshirë trajnime në fushën e zonave të mbrojtura, mbrojtjes së natyrës dhe menaxhimit të territorit, duke zgjeruar njohuritë dhe kompetencat e tij në funksion të detyrës që ushtron pranë Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Dibër.